# BIOGRAFIA

**Gjylieta Mushkolaj**
**Universiteti i Prishtinës**
**Fakulteti Juridik**
**Cell: 045 266 506**
**E-mail: gjylieta@gmail.com**

---

Dr. Gjyljeta Mushkolaj është Profesor i asocuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ku është edhe shef i Katedrës kushtetuese administrative dhe anëtare e Këshillit të Doktoratës. Njëkohësisht është bashkëthemeluese dhe anëtare e Bordit të Drejtorëve të Universitetit Amerikan në Kosovë.

Gjatë karrierës së vet profesionale, për kontribut në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut ka fituar një sërë çmimesh, përfshirë çmimin për drejtësi **"Heroi Sali Çekaj"** dhe çmimin ***"Pioniere femër në fushën e drejtësisë".***

Gj. Mushkolaj ishte Gjyqtare e gjeneratës së parë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Paraprakisht ka qenë anëtare e Komisionit Kushtetues të Kosovës, organit me rëndësi historike për hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, anëtare e grupit për themelimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, eksperte për decentralizim e Ekipit Negociator të Kosovës dhe anëtare e Këshillit të Përbashkët Këshillues të UNMIK-ut për Çështje Legjislative.

Para emërimit në Gjykatën Kushtetuese, Gj. Mushkolaj shërbeu si Zëvendës Komisionere për Ndihmë Juridike dhe anëtare e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës.

Që nga viti 1999 Gj. Mushkolaj ka punuar me zyrtarë qeveritarë, parlamentarë, gjyqtarë, avokatë dhe përfaqësues të OJQ-ve për zhvillimin e një kuadri të shëndoshë ligjor dhe fiskal për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në Kosovë dhe shtetet tjera të Evropës Jugore. Ajo gjithashtu ka punuar me organizata të rëndësishme ndërkombëtare në projekte me rëndësi për lirinë e asocimit. Gjatë karrierës së saj, Gjyqtarja Mushkolaj ka qenë pjesëmarrëse aktive e shoqërisë civile.

Përvoja e saj paraprake e punës përfshinë Qendrën Ndërkombëtare për të Drejtën Jo-për-Përfitim nëWashington D.C., Qendrën Amerikane në Prishtinë (USIS), dhe Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë.

Gj.. Mushkolaj studimet e drejtësisë i ka kryer në Universitetin e Prishtinës. Studimet post-diplomike (LL.M.) i ka përfunduar në Universitetin CEU/Universitetin Shtetëror tëNew York-ut. Magjistraturën e dytë dhe studimet e doktoraturës nga fusha e të drejtës kushtetuese i ka mbaruar në Universitetin e Prishtinës.

## EDUKIMI

**2007 - Doktor i shkencave juridike, Universiteti i Prishtinës.**
Tema: "MARRËDHËNIET MIDIS PUSHTETIT QENDROR DHE PUSHTETIT LOKAL - BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE"
Tema është e mbrojtur me sukses të dalluar.

**1995 - Magjistër i Shkencave Juridike, Universiteti i Prishtinës.**
Tema: "ASPEKTI KUSHTETUES JURIDIK I LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT NË ISH-JUGOSLLAVI NË PERIUDHËN 1945-1991"

**1994 - Legum Magister, CEU, The State University of New York.**
Tema: "PREVENTIVE PROTECTION OF REFUGEES IN A NEW WORLD ORDER"

**1986 - Jurist i Diplomuar, Universiteti i Prishtinës.**

## Përvoja Profesionale

**Universiteti i Prishtinës, Fakulteti juridik, Prishtinë, Republika e Kosovës , 1988 - Aktualisht**
*Prof. Asoc.*

Në vitin 1988 u zgjodh asistent praktikant në Fakultetin juridik të Universitetit të Prishtinës për lëndën "Fillet e së drejtës".

Në studimet themelore i ka ligjëruar lëndët: "Fillet e së drejtës,"E drejta dhe Etika", "Metodologjia ligjore";

Në studimet master i ligjëron lëndët: "Liritë dhe të drejtat individuale", "E drejta jo-për-përfitim"

Nw Fakultetin Filologjik tw Universitetit tw Prishtinws, Programin master pwr pwrktthim e ligjwron lwndwn Bazat e sw drejtws.

**Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Prishtinë, Republika e Kosovës , 2009 - 2012**
*Gjyqtare*

**Komisioni Kushtetues i Republikës së Kosovës, 2007 – 2008**
*Anëtare, Kryesuese e Nën-Komisionit për të drejta të njeriut dhe Kryesuese e Zyrës për marrëdhënie me publikun, si dhe anëtare e grupit për harmonizim të versionit përfundimtar të Kushtetutës.*

**Ekipi i Unitetit, 2006 – 2007**
*Eksperte për decentralizim*

**International Center for Not-for-Profit Law, Washington, D.C., U.S.A., September 1999 – 30 August 2000**
*Këshilltar ligjor ndërkombëtar (Program Fellowship-i)*

**United States Information Service, Government / Public Diplomacy, Prishtina, Kosovo, 1 October 1996 – 30 August 1999**
*Specialist i diplomacisë publike*

**United Nations Office in Geneva, UN Commission on Human Rights, Sub-Commission on Prevention of Discrimination and Protection of Minorities, January 1994 – 30 April 1994**
Anëtare e grupit për përgatitjen e Sesionit të 50ttë Jubilar për të drejtat e njeriut si dhe përe përgatitjen e Raportit Përfundimtar të Sesionit.

## Njohja e gjuhëve

Shqip - Gjuhë amtare; Anglisht – shkëlqyeshëm; Serbo-Kroatisht, shkëlqyeshëm; Frëngjisht, mirë.

**Aktivitetet Profesionale dhe shoqërore**

- Komisioni Kushtetues i Kosovës, anëtare, Kryesuese e nën-komisionit për të drejta të njeriut dhe Kryesuese e Zyrës për marrëdhënie me publikun.
- Grupi për themelimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës
- American University in Kosovo, Anëtare dhe Sekretare e Bordit te Drejtorëve.
- Komisioni për Ndihmë Juridike, Zëvendës-Komisionare
- CiviKos, Kryetare e Bordit të Drejtorëve.
- Community Development Fund, Anëtare e Bordit të Drejtorëve.
- Koalicioni "Mirëqenie për të gjithë", anëtare.
- International Human Rights Education Consortium, anëtare.

**Mirënjohjet**

| | |
|---|---|
| 2013 | Çmimi për Drejtësi "Heroi Sali Çekaj" |
| 2010 | OAK, ABA ROLI dhe USAID**:** ***"****Pioniere femër në fushën e drejtësisë".* |
| 2005 | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve: "Shpërblim për Kontribut të veçantë në Përgatitjen e Projekt-Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë ". |
| 1999 | United States Information Agency East European and NIS Affairs: "Foreign Service National Employee of the Year" |
| 1993 | Open Society Foundation Scholarship |

**Publikimet e zgjedhura**

"*Mbrojtja ndërkombëtare e lirive dhe të drejtave të njeriut*", Doracaku për përgaditjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë dhe UNDP, 2009, Prishtinë

"*Mbrojtja europiane e lirive dhe të drejtave të njeriut*", Doracaku për përgaditjen e provimit të jurisprudencës, Ministria e Drejtësisë dhe UNDP, 2009, Prishtinë

"*Local Government and the Right to Freedom of Association*", "Kosovo Decentralization Dialogue", LGI/OSI Budapest, and KFOS Prishtina, 2006, Prishtinë

*"NGO and Government Partnership"*, "Kosovo Decentralization Dialogue", LGI/OSI Budapest, and KFOS Prishtina, 2006, Prishtinë

*"Këshilli i Evropës dhe mbrojtja e Lirive dhe të drejtave të njeriut",* "Manual për përgaditjen e provimit të jurisprudencës", Prishtinë, OSCE dhe Kosovar Institute for Euro-Atlantic Integration, 2004, Prishtinë.

*"Human Rights Glossary*," UNESCO në bashkëpunim me Finnish Human Rights Project, 2002, Tiranë, Prishtinë.

*"Këshilli i Evropës dhe mbrojtja e Lirive dhe të drejtave të njeriut"*, "Manual për përgatitjen e provimit të jurisprudencës", Prishtinë, OSCE dhe Kosovar Institute for Euro-Atlantic Integration, 2001, Prishtinë.

*Kosovo: "Managing NGOs in a New Legal Environment",* "International Journal For Not-For-Profit Laë", 2000, Ëashington, DC.

"*The Electoral Provisions for the Municipal Election in Kosovo*," "Local Election Observation of the Kosova Municipal Elections," Kosova Action for Civic Initiatives (KACI), Prishtina, 2000, Prishtinë